

KËRKESË PËR OFERTË PËR BLERJEN E ARTIKUJVE PROMOVUESE

Procedura për kuotimin e çmimeve

Numri kërkesës për ofertim:	DFO 004 /24
Data e ftesës:	16.05.2024
Data e mbylljes:	31.05.2024
Titulli i kontratës:	Blerja e artikujve promovuese
Autoriteti Kontraktues	DokuFest
Adresa:	DokuFest - Rr.Marin Barleti Pn.,20000 Prizren
E-mail:	procurement@dokufest.com

PËRMBLEDHJE

DokuFest ju fton të paraqisni ofertat për:

KËRKESË – Blerja e artikujve promovuese

DokuFest hap thirrjen për furnizues të kualifikuar që të paraqesin ofertat e tyre për produktet promovuese të DokuShop.

Ftojme kompanitë e interesuara të paraqesin ofertat e bazuara në dokumentin e detajzuar më poshtë.

Afati i fundit për dërgim është 31 Maj 2024.

Lusim të interesuarit të dërgojnë ofertat në emailin zyrtar: procurement@dokufest.com

KUSHTET E DETYRUESHME PËR PJESËMARRJE

Të gjithë të ftuarit duhet të dorëzojnë ofertën e tyre siç parashihet më poshtë.

Ofertat duhen të shënojnë / ofrojnë informacionin e mëposhtëm shtesë:

- Duhet të shënohet numri i ftesës për ofertim
- Duhet të shënohet data e ofertës
- Duhet të ofrohet vlefshmëria e ofertës. (Vlefshmëria e ofertës duhet të jetë së paku 30 ditë),
- Për kompanitë duhet të ofrohen dokumentet zyrtare të kompanisë në vijim: Çertifikata e regjistrimit të biznesit, Informatat për biznesin, çertifikata fiskale dhe çertifikata e TVSH-së (të gjitha në kopje/scan) si dhe licenca nga organet kompetente për kryerjen e punëve.

- Për konsulentët duhet të ofrohet: Kopja e Letënjoftimit dhe Licenca nga organet kompetente për kryerjen e punëve
- Oferta financiare duhet të jetë në Euro dhe te ceket cmimi për materialet, propozimet, dhe intervistat (me te gjitha taksat),
- Në rast se TVSH-ja nuk është përcaktuar, Dokufest do të konsiderojë se çmimi përfshinë TVSH- në,
- Ofertat mund të përgatiten në ndonjërin prej gjuhëve zyrtare në Kosovë apo në gjuhë angleze,
- Afati i fundit i dorëzimit të ofertës është 31.05.2024 ora 00:00.

SHËNIM ME RËNDËSI:

- Mosplotësimi i ndonjërit prej kushteve të detyrueshme për pjesëmarrje ju diskualifikon nga pjesëmarrja e mëtejme në vlerësim të Ofertës suaj.
- Me rastin e nënshkrimit të kontratës, kompania/konsulenti/ja fituese duhet të prezentoj vërtetimin nga Administrata Tatimore e Kosovës që nuk ka borxhe, jo më të vjetër se 90 ditë.
- Çdo palë e interesuar mund të bejë ankesë pranë autoritetit kontraktues brenda afatit 7 (shtatë) ditë nga data e njoftimit.

KUSHTET DHE RREGULLAT E KUOTIMIT

- Afati i fundit i dorëzimit të ofertës është 31 Maj 2024, ora 00:00.
- Për çdo pyetje, mund të dërgoni kërkesë me shkrim përmes email-it në këtë adresa: procurement@dokufest.com, . Pyetjet pranohen deri më 30 Maj 2024.
- Hapja e ofertave do të bëhet me 03 Qershor 2024. Komisioni përzgjedhës
- Me rastin e hapjes së ofertave dhe në rast që shtrohet nevoja, Komisioni Vlerësues ka të drejtë të bëjë pyetje shtesë ndaj ofertuesve. Pyetjet do të komunikohen tek të gjitha palët.
- Ofertat do të vlerësohen në bazë të kriterëve të mëposhtme kualitative dhe kuantitative.

KRITERET	%
1. Kriteret Kualitative	
1.1. Pergaditja, pervoja, propozimet konkrete	40%
2. Kriteret Financiare	
2.1. Ofertë ekonomikisht më e favorshme	60%
Total:	100%